

AKT NORMATIV
Nr. 1, datë 3.4.2026

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 61/2012, “PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë,” të ndryshuar, bëhet shtesa e mëposhtme:

Neni 1

Pas pikës 9, të nenit 109, “Dispozita kalimtare”, shtohet pika 10, me këtë përmbajtje:

“10. Përfundimisht, në rastet kur në bazë të vendimit të Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe Gazit (në vijim Bordi), i ngritur në përputhje me ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, çmimi tavan për shitjen me pakicë për benzinën dhe gazoilin është mbi nivelet e mëposhtme:

a) 200 lekë/litri për benzinën;

b) 220 lekë/litri për gazoilin,

niveli i akcizës së këtyre produkteve zbatohet në masën 80% të niveleve të caktuara në shtojcën nr. 1, të ligjit nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë,” të ndryshuar, si më poshtë vijon:

- Benzinë, sipas kodeve të NKM-së: 27101245 dhe 27101249, niveli i akcizës është 31.50098 lekë/litri;

- Gazoil, sipas kodit të NKM-së: 27101944, niveli i akcizës është 31.50098 lekë/litri.”.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare, si dhe i shtrin efektet përgjatë kohëzgjatjes së situatës së veçantë në tregun e hidrokarbureve në territorin e Republikës së Shqipërisë, të shpallur me vendimin nr. 186, datë 19.3.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e situatës së veçantë në tregun e hidrokarbureve”.

KRYEMINISTËR
Edi Rama